



UNIVERSITETI
BARLETI



MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET

UNIVERSITETIT BARLETI

DHE

ICEBERG COMMUNICATION

TIRANË

ME DATË 04/11/2022



PALËT BIEN DAKORD si vijon:

NENI I

OBJEKTIVI

Palët e kësaj marrëveshje Bashkëpunimi, duke vepruar mbi bazën e dispozitave të saj si dhe akteve ligjore e nënligjore në fuqi, do të përpiqen të përforcojnë, promovojnë dhe zhvillojnë bashkëpunimin e tyre reciprok mbi bazën e barazisë dhe përfitimit të përbashkët në cdo fushë të kesaj marrëveshje.

NENI II

FUSHAT E BASHKËPUNIMIT

1. Iceberg Communication do të angazhojë, sipas një plani të caktuar, student dhe të diplomuar të universitetit në punë promovuese, nëse ekziston gatishmëria dhe dëshira e mirë e personave në fjalë.
2. Iceberg Communication në kuadër të veprimtarisë së vet, do t'ju mundësojë studentëve te universitetit BARLETI kryrjen e praktikës profesionale të parashikuar në planin mësimor. Dinamika e realizimit të punës praktike do të përcaktohet me dokumentacion të vecantë qe specifikon detyrimet e palëve për cdo grup praktike të cdo fakulteti.
3. Ekspertë të Iceberg Communication do të kenë mundësinë të mbajnë në universitetin BARLETI leksione për promovimin e institucionit të tyre dhe të veprimtarisë së tij.
4. Universiteti BARLETI do të aplikojë tarifa preferenciale për anëtarët e stafit të Iceberg Communication të cilët do të ndjekin studimet në programet e studimit të universitetit.
5. Palët do të realizojnë veprimtari të përbashkëta kërkimore, promovuese dhe marketing, me qëllim rritjen e cilësisë, imazhit të institucioneve respektive si dhe sensibilizimin e qytetarëve me projektet e përbashkëta të dy institucioneve.
6. Palët do të zhvillojnë forume të përbashkëta, konferenca shkencore, simpoziume, seminare, dhe shumë veprimtari te tjera të këtij lloji me interes reciprok.
7. Palët do të zhvillojnë veprimtari të përbashkëta promovuese dhe marketing, me qëllim sensibilizimin e qytetarëve me projektet e përbashkëta të dy institucioneve.



8. Palët do të shkëmbejnë materiale akademike dhe informacione të tjera duke respektuar parimin e konfidencialitetit dhe mirëbesimit.
9. Universiteti BARLETI do të zhvillojë tarifa preferenciale për të gjitha studimet, konsulentat, këshillimet apo trajnimet që do të realizojë për Iceberg Communication

NENI III

KUSHTET E BASHKEPUNIMIT

1. Kjo marrëveshje Bashkëpunimi nuk shoqërohet me detyrime apo impakt financiar ndërmjet palëve përveç rasteve kur palët bien dakort ndryshe.
2. Kostot dhe shpenzimet që lindin nga kjo marrëveshje do të mbulohen nga secila palë me buxhetin e tyre.
3. Nëse nga bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve bazuar në parimet e mësipërme, lind nevoja për financimin e projekteve të përbashkëta, të dy institucionet do t'i rregullojnë këto raporte me anë të marrëveshjes së vecantë financiare, të cilat do të jenë pjese integrale e kësaj Marrëveshje.
4. Të dy palët, në bazë të mundësive, mjeteve financiare që disponojnë dhe potencialit akademik e professional, do të aplikojnë në organizma dhe institucione të ndryshme për realizimin e projekteve të përbashkëta.
5. Rezultatet e këtij bashkëpunimi dhe përfitimet reciproke kur ato ekzistojnë bëhen publike vetëm me aprovimin e të palëve. Palët ruajnë konfidencialitetin e informacioneve të perfituara nga njëri-tjetri.
6. Palët dakordohen që të ruajnë dhe të respektojnë integritetin reciprok.

NENI VI

EFEKTET E KESAJ MARREVEESHJE

Kjo marrëveshje mirëkuptimi nuk përbën ose krijon dhe nuk ka për qëllim të përbëjë ose të krijojë detyrime ligjore detyruese ose të zbatueshme, të shprehura ose të nënkuptuara.